



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 26.12.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.12.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Vlera SHPK" për aktivitetin: "Sherbimet e DDD-se për institucionet arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9412-421 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "VLERA" e datës 21.12.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sherbimet e veçanta kontraktuale për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9412-221, kundër Njoftimit për *Vendimin e AK-se për anulim të kontratës* të AK –së, të datës 19.12.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Mbetet në fuqi Vendimi për dhenje të kontratës** i publikuar me datë: 19.12.2019;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Vlera SHPK" me datë 21.12.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sherbimet e DDD-se për institucionet arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9412-421.

Autoriteti Kontraktues, me datë 26.12.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet janë të pa bazuara pasi që Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedurë emergjente për shkak se si që e dini edhe ju procedura e rregullte ka kohe që është në ankesë. Që të mos ketë favorizime apo kufizime në ua kemi dërguar ftesën të gjithë tenderuesëve nga procedura e rregullte dhe kriteri ka qenë çmimi më i lirë. Në këtë procedurë për shkak të kërkesave emergjente Autoriteti Kontraktues nuk ka komoditet

per analiza as te çmimeve e as analiza tjera dhe per kete jane marre Vendime qe ju i quani te nxituara, e qe faktikisht jane plotesisht te ligjshme dhe te domosdoshme. Pra ketu kemi procedure emergjente dhe nuk eshte shkelur asnje dispozite ligjore.

Ne baze te sqarimeve paraprahe u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

Zyrtarja e prokurimit qe administron kete lende duhet te publikoj kete Vendim ne E Prokurim.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit